

RELACION

PËR

PROJEKTLIGJIN “PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.10431, DATË 9.6.2011, PËR MBROJTJEN E MJEDISIT”, TË NDRYSHUAR

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Qëllimi i projektligjit është që të lehtësojë personat fizikë/juridikë nga procedurat administrative lidhur me detyrimin për t’u pajisur me leje të tipit C, për aktivitete që kanë ndikimin të ulët në mjedis dhe niveli i shkarkimeve në mjedis gjatë operimit të tyre është i pallogaritshëm.

Nëpërmjet ndryshimit të këtij ligji synohet ndryshimi i sistemit të lejeve të mjedisit, duke e ndryshuar atë nga një sistem prej tri nivelesh të lejeve të mjedisit, tipi A, B apo C, në një sistem vetëm me dy nivele të lejeve të mjedisit, përkatësisht, leje të tipit A dhe B, duke eliminuar kështu lejet e mjedisit të tipit C.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Rishikimi i ligjit të sipërcituar bëhet në kuadër të paketës antikorruption, të rritjes së transparencës në fushën e mjedisit, si dhe në përputhje me Reformën e Derregulimit e nuk është parashikuar në programin analitik të akteve për vitin 2019, pasi është një nismë e ndërmarrë së fundi në kuadër të ndalimit të informalitetit dhe korrupsionit.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Miratimi i këtij projektligji do të mundësojë bërjen e ndryshimeve të nevojshme edhe në ligjin nr.10448, datë 14.7.2011, “Për lejet e mjedisit”, të ndryshuar, ku të parashikohet se për aktivitetet që kanë ndikimin të ulët në mjedis dhe niveli i shkarkimeve në mjedis të cilave gjatë operimit të tyre është i pallogaritshëm, të mos jetë më nevoja të pajisen me leje mjedisi të tipit C, e cila u sjell qytetarëve dhe subjekteve humbje kohe dhe kosto për pajisjen me këtë leje.

Pushteti qendror nuk mund të angazhohet për të lëshuar më leje mjedisi të tipit C për aktivitete, ndikimi i të cilave në mjedis është tepër minimal, ndërkohë që fokusi i ministrisë përgjegjëse për mjedisin dhe institucioneve të saj të varësisë është kontrolli dhe monitorimi i ndotësve të mëdhenj industrialë.

Ndryshimet e propozuara lehtësojnë ndjeshëm, si në kohë, por mbi të gjitha në kosto financiare, subjektet që tashmë operojnë me një leje mjedisi (tipi C), pasi ata lirohen nga tarifa vjetore e lejes së mjedisit, por nga kostoja dhe tarifa e përgatitjes së raporteve për zbatueshmërinë e kushteve të lejes së mjedisit të tipit C (një ose dy herë në vit). Gjithashtu, është një proces i rëndësishëm dhe në kuadër të reformës antikorrupsion dhe për lehtësimin e procedurave për këto biznese, kryesisht të vogla, me një ndikim të ulët në mjedis.

Konkretisht, nga ndryshimi i sistemit të lejeve të mjedisit, duke hequr lejet e tipit C, përfitojnë rreth 6900 operatorë, të cilët nuk kanë më detyrimin të pajisen me leje mjedisi të tipit C. Pra, hiqet nevoja për t'u pajisur me leje mjedisi për 47 aktivitete.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Ndryshimi i ligjit të sipërcituar bëhet në përputhje me programin e qeverisë për të luftuar informalitetin dhe korrupsionin, që është një nismë për të thjeshtuar procedurat administrative për shërbimet e ofruara ndaj personave fizikë/juridikë dhe, për rrjedhojë, për të ulur korrupsionin.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Ndryshimet e propozuara në projektligj nuk transpozojnë akte të Bashkimit Evropian.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Për të lehtësuar kuptimin e këtij projektligji, sqarojmë se parimet e procedurës dhe institucionet përgjegjëse, si dhe aktivitetet/instalimet bazë që duhet të pajisen me leje mjedisi janë përcaktuar e miratuar në ligjin nr.10448, datë 14.7.2011, "Për lejet e mjedisit", të ndryshuar.

Ky projektligj synon të përcaktojë vetëm sistemin e ri të lejeve të mjedisit të përbërë vetëm me dy nivele të lejeve të mjedisit, përkatësisht leje të tipit A dhe

B, duke eliminuar kështu lejet e mjedisit të tipit C, si dhe reflektimin e ndryshimit të organeve inspektuese, referuar ristrukturimit të institucioneve të varësisë të MTM-së, përkatësisht ristrukturimi i AKM-së dhe shkrirja e ISHMPUT-së.

Në nenin 1 është parashikuar që neni 29, i ligjit ekzistues, ndryshohet duke përcaktuar sistemin e ri të lejeve të mjedisit prej dy nivelesh, përkatësisht të tipit A dhe B.

Në nenet 2 e 3 bëhen zëvendësime në tekstin e ligjit, që kanë të bëjnë me ndryshimin e organit inspektues në fushën e mjedisit dhe referencat “A, B dhe C” zëvendësohen me “A dhe B”.

Aktivitetet, si: pikat e karburanteve, furrat e bukës, gatimi dhe tregtimi i produkteve ushqimore (restorante), magazinimi frigoriferik, depot farmaceutike apo larje dhe pastrim mjetesesh motorike (lavazhet), nuk kanë më detyrim të pajisen me leje mjedisi, pasi ndikimi që kanë ato në emetimin e gazrave serë dhe të atyre gazrave që dëmtojnë shtresën e ozonit është i papërfillshëm, si dhe shkarkimet në trupat ujorë pritës nga këto aktivitete janë tepër minimale dhe, në shumicën e rasteve, ujërat që shkarkohen nga këto aktivitete trajtohen si ujëra të ndotura urbane. Gjithashtu, projektligji synon të fokusohet mbi aktivitetet industriale që vërtet mund të ndotin mjedisin e të cenojnë shëndetin e njeriut. Për këtë arsye, ky projektligj e thjeshton sistemin e lejeve në Republikën e Shqipërisë vetëm në 2 tipe (nga 3 që ka ligji në fuqi), duke mbajtur vetëm lejet e tipit A, të cilat vijnë si detyrim direkt nga Direktiva 2010/75/EC dhe lejet e tipit B, ku bëjnë pjesë aktivitet e tipit A, por me kapacitete më të ulëta se ato që jepen në Direktivë. Në këtë mënyrë, vëmendja e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit dhe e strukturës përgjegjëse inspektuese në fushën e mjedisit do të përqendrohet aty ku janë rreziqet reale për ndotjen e mjedisit. Aktivitetet që, sipas ligjit në fuqi, kishin nevojë për leje të tipit C, me miratimin e këtij projektligji, nuk do të kenë më nevojë për leje mjedisi.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E PROJEKTAKTIT

Ngarkohen Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Mjedisit dhe Qendra Kombëtare e Biznesit për zbatimin e këtij ligji.

VIII. MINISTRITË, INSTITUCIONET DHE SUBJEKTET E TJERA QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Ky projektligj është bashkërenduar me Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural,

Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, me Ministrin e Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe Agjencinë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Zbatimi i projektligjit nuk ka efekte financiare shtesë për buxhetin e shtetit, pasi të gjitha strukturat për shqyrtimin e pranimin e aplikimeve për leje mjedisi të tipit A dhe B janë të ngritura, ndërkohë që ka një lehtësim lidhur me procesin e aplikimit për lejet e mjedisit të tipit C, të cilat nuk do të ekzistojnë më.

KËSHILLI I MINISTRAVE